



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI

Rasti: Përfitim Kontrolli/ 407- PORSCHE /VOLKSWAGEN

1. Në datën 12 Shtator 2008, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e përqendrimit të propozuar në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me objekt përfitimin e kontrollit të plotë nga shoqëria Porsche AG (Porsche Gjermani), në shoqërinë Volkswagen AG (Volkswagen Gjermani), nëpërmjet blerjes së aksioneve.
2. Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:
 - Për Porsche: prodhimi dhe shpërndarja (shitja) e autoveturave;
 - Për Volkswagen: prodhimi dhe shpërndarja (shitja) e autoveturave dhe automjeteve komerciale.
3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Autoriteti konstatoi që transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12, pika 1 të Ligjit. Blerësi, shoqëria Porsche, është e pranishme në tregun e shpërndarjes (shitjes) të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet shoqërisë bijë të saj, Porsche Albania Sh.p.k.
4. Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4 Tiranë; apo me e-mail në adresën perqendrime@caa.gov.al